

**VENDIM**  
**Nr. 706, datë 26.11.2025**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1128, DATË 30.12.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR ZBATIMIN NGA REPUBLIKA E SHQIPËRISË TË VENDIMEVE TË KËSHILLIT TË BASHKIMIT EVROPIAN PËR VENDOSJEN, NDRYSHIMIN DHE SHFUQIZIMIN E MASAVE SHTRËNGUESE NDËRKOMBËTARE, TË NDRYSHUARA”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, pika 3, shkronja “c”, e 6, pikat 2 e 5, të ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

I. Në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në kreun I bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Në pikën 1, pas fjalëve “... (CFSP) 2025/960 ...” shtohen “... (CFSP) 2025/2072 ...”;

b) Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Vendimin e Këshillit të Bashkimit Evropian (CFSP) 2010/638, “Në lidhje me masat kufizuese, në funksion të situatës në Guinea”, të ndryshuar me vendimet e Këshillit të Bashkimit Evropian (CFSP) 2011/169, (CFSP) 2011/706, (CFSP) 2012/149, (CFSP) 2014/213, (CFSP) 2014/728, (CFSP) 2015/1923, (CFSP) 2016/1839, (CFSP) 2017/1934, (CFSP) 2018/1611, (CFSP) 2019/1790, (CFSP) 2020/1556, (CFSP) 2021/1867, (CFSP) 2021/1305, (CFSP) 2022/2052, (CFSP) 2023/2227, (CFSP) 2024/2693, (CFSP) 2025/2080, sipas aneksit 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.

2. Në aneksin 1, bashkëlidhur vendimit, shtohet vendimi (CFSP) 2025/2072, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Në aneksin 2, bashkëlidhur vendimit, shtohet vendimi (CFSP) 2025/2080, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Ngarkohen organet e parashikuara në pikën 1, të nenit 11, të ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**



**VENDIMI I KËSHILLIT (CFSP) 2025/2072**  
**i 13 tetorit 2025**  
**që ndryshon Vendimin (CFSP) 2018/1544 mbi masat kufizuese kundër përhapjes dhe**  
**përdorimit të armëve kimike**

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Bashkimin Evropian, dhe në veçanti Nenin 29 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë,

Ndërsa:

- (1) Më 15 tetor 2018, Këshilli miratoi Vendimin (CFSP) 2018/1544 <sup>(1)</sup>.
- (2) Masat kufizuese të përcaktuara në Vendimin (CFSP) 2018/1544 zbatohen deri më 16 tetor 2025. Në bazë të një rishikimi të Shtojcës së Vendimit (CFSP) 2018/1544, masat e përcaktuara në nenet 2 dhe 3 të atij Vendimi në lidhje me personat fizikë ose juridikë, entitetet dhe organet e listuara në atë Shtojcë duhet të zgjaten deri më 16 tetor 2026.
- (3) Prandaj, Vendimi (CFSP) 2018/1544 duhet të ndryshohet në përputhje me rrethanat,

**KA MIRATUAR KËTË VENDIM:**

Neni 1

Neni 8(1) i Vendimit (CFSP) 2018/1544 zëvendësohet me sa vijon:

‘1. Ky Vendim do të zbatohet deri më 16 tetor 2026. Ky Vendim do të mbahet nën shqyrtim të vazhdueshëm.’.

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi ditën pas publikimit të tij në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Luksemburg, më 13 tetor 2025.

Për Këshillin

President

P. HUMMELGAARD

<sup>(1)</sup> Vendimi i Këshillit (CFSP) 2018/1544 i 15 tetorit 2018 mbi masat kufizuese kundër përhapjes dhe përdorimit të armëve kimike (OJ L 259, 16.10.2018, f. 25, ELI: <http://data.europa.eu/eli/dec/2018/1544/oj>).



2025/2072

14.10.2025

**COUNCIL DECISION (CFSP) 2025/2072**

**of 13 October 2025**

**amending Decision (CFSP) 2018/1544 concerning restrictive measures against the proliferation and use of chemical weapons**

THE COUNCIL OF THE EUROPEAN UNION,

Having regard to the Treaty on European Union, and in particular Article 29 thereof,

Having regard to the proposal from the High Representative of the Union for Foreign Affairs and Security Policy,

Whereas:

- (1) On 15 October 2018, the Council adopted Decision (CFSP) 2018/1544 <sup>(1)</sup>.
- (2) The restrictive measures set out in Decision (CFSP) 2018/1544 apply until 16 October 2025. On the basis of a review of the Annex to Decision (CFSP) 2018/1544, the measures set out in Articles 2 and 3 of that Decision as regards the natural or legal persons, entities, and bodies listed in that Annex should be extended until 16 October 2026.
- (3) Decision (CFSP) 2018/1544 should therefore be amended accordingly,

HAS ADOPTED THIS DECISION:

*Article 1*

Article 8(1) of Decision (CFSP) 2018/1544 is replaced by the following:

- '1. This Decision shall apply until 16 October 2026. This Decision shall be kept under constant review.'

*Article 2*

This Decision shall enter into force on the day following that of its publication in the *Official Journal of the European Union*.

Done at Luxembourg, 13 October 2025.

*For the Council*

*The President*

P. HUMMELGAARD

<sup>(1)</sup> Council Decision (CFSP) 2018/1544 of 15 October 2018 concerning restrictive measures against the proliferation and use of chemical weapons (OJ L 259, 16.10.2018, p. 25, ELI: <http://data.europa.eu/eli/dec/2018/1544/oj>).



2025/2080

14.10.2025

**VENDIMI I KËSHILLIT (CFSP) 2025/2080**

**i 13 tetorit 2025**

**që ndryshon Vendimin 2010/638/CFSP mbi masat kufizuese në lidhje me situatën në Guine**

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Bashkimin Evropian, dhe në veçanti Nenin 29 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë,

Ndërsa:

- (1) Më 25 tetor 2010, Këshilli miratoi Vendimin 2010/638/CFSP <sup>(1)</sup>,
- (2) Në bazë të një rishikimi të Vendimit 2010/638/CFSP, masat kufizuese të përcaktuara në të duhet të zgjaten deri më 27 tetor 2026.
- (3) Prandaj, Vendimi 2010/638/CFSP duhet të ndryshohet në përputhje me rrethanat,

KA MIRATUAR KËTË VENDIM:

*Neni 1*

Në nenin 8(2) të Vendimit 2010/638/CFSP, data '27 tetor 2025' zëvendësohet me atë '27 tetor 2026'.

*Neni 2*

Ky Vendim hyn në fuqi ditën pas publikimit të tij në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Luksemburg, 13 tetor 2025.

*Për Këshillin*

Presidenti

P. HUMMELGAARD

<sup>(1)</sup> Vendimi i Këshillit 2010/638/CFSP i 25 tetorit 2010 mbi masat kufizuese në lidhje me situatën në Guine (OJ L 280, 26.10.2010, f. 10, ELI: <http://data.europa.eu/eli/dec/2010/638/oj>).



2025/2080

14.10.2025

**COUNCIL DECISION (CFSP) 2025/2080**  
**of 13 October 2025**  
**amending Decision 2010/638/CFSP concerning restrictive measures in view of the situation in**  
**Guinea**

THE COUNCIL OF THE EUROPEAN UNION,

Having regard to the Treaty on European Union, and in particular Article 29 thereof,

Having regard to the proposal from the High Representative of the Union for Foreign Affairs and Security Policy,

Whereas:

- (1) On 25 October 2010, the Council adopted Decision 2010/638/CFSP<sup>(1)</sup>.
- (2) On the basis of a review of Decision 2010/638/CFSP, the restrictive measures set out therein should be extended until 27 October 2026.
- (3) Decision 2010/638/CFSP should therefore be amended accordingly,

HAS ADOPTED THIS DECISION:

*Article 1*

In Article 8(2) of Decision 2010/638/CFSP, the date '27 October 2025' is replaced by that of '27 October 2026'.

*Article 2*

This Decision shall enter into force on the day following that of its publication in the *Official Journal of the European Union*.

Done at Luxembourg, 13 October 2025.

*For the Council*

*The President*

P. HUMMELGAARD

---

<sup>(1)</sup> Council Decision 2010/638/CFSP of 25 October 2010 concerning restrictive measures in view of the situation in Guinea (OJ L 280, 26.10.2010, p. 10, ELI: <http://data.europa.eu/eli/dec/2010/638/oj>).